

# Banka e Shqipërisë



## Rezultatet e Vrojtimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

**Shkurt 2009**


Publikimi i ardhshëm i rezultateve të Vrojtimit të Biznesit dhe të Konsumatorit do të bëhet në 15 maj 2009

### Tendenca ekonomike

Në tremujorin e katërt të vitit 2008 Treguesi i Tendencës Ekonomike (TTE) ra me 10 pikë përqindjeje duke shënuar vlerën 105.3. Treguesi i tendencës, i cili shënoi rritje në tremujorin e dytë dhe atë të tretë të vitit të kaluar, respektivisht me 2 dhe 9 pikë përqindjeje, aktualisht qëndron 4 pikë përqindjeje më lart se sa mesatarja afatgjatë e tij.

Ulja në treguesin e tendencës së ekonomisë në tremujorin e fundit të vitit 2008 është përcaktuar nga rënia në tre nga katër sektorët, balancat e të cilëve formojnë TTE. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008 u regjistrua rënie e besimit në sektorin e shërbimeve, në atë të industrisë dhe rënie e besimit të konsumatorëve. Në kontrast me sektorët e tjerë, treguesi i besimit të ndërtimit shënoi rritje, duke dhënë kontribut pozitiv në ecurinë e treguesit të përgjithshëm të ekonomisë. Aktualisht treguesit e besimit të industrisë dhe të konsumatorëve qëndrojnë poshtë mesatares së tyre afatgjatë.

Grafik 1: Treguesi i Tendencës Ekonomike.




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

## Sektori i industrisë

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) në T4-08 vijoi prirjen e lehtë rënëse që nga tremujori i kaluar. Treguesi i besimit, i cili kishte shënuar rënie me 1.2 pikë përqindjeje në T3-08, ra me 0.3 pikë përqindjeje në tremujorin e fundit të vitit, i ndikuar kryesisht nga përkeqësimi në situatën e *punësimit*. Ndërkohë, përmirësimi i vlerësimeve të bizneseve për *prodhimin* industrial dhe pakësimi i *inventarëve* në T4-08, kontribuan pozitivisht në TBI.

Grafik 2: Treguesi i Besimit të Industrisë.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

### Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBI.

Vlerësimet e bizneseve për *kërkesën e brendshme* dhe për *kërkesën për eksporte* në T4-08 janë ulur krahasuar me një tremujor më parë. *Gjendja e përgjithshme* e biznesit dhe *ecuria e ekonomisë* në vend janë gjykuar në rënie nga bizneset e industrisë, në krahasim me vërtetimin e kaluar. Faktorët që kanë ndikuar negativisht aktivitetin e bizneseve janë kryesisht problemet që lidhen me praninë e ekonomisë informale dhe problemet me energjinë elektrike.

Shfrytëzimi i *kapaciteteve* prodhuese në T4-08 vlerësohet në ulje në krahasim me tremujorin e tretë. *Norma e shfrytëzimit* të kapaciteteve për industrinë në T4-08 është 72.4%, më e lartë për degën e industrisë së mallrave të konsumit dhe degën e industrisë përpunuese dhe më e ulët për degën industrisë së mallrave kapitalë (përkatesisht, 73.8%, 73.1% dhe 70.3%)

*Kontratat* e porositësve paraqiten negative dhe në rënie nga vërtetimi i kaluar. *Kapaciteti* aktual i prodhimit vlerësohet i mjaftueshëm, duke marrë parasysh *kërkesën aktuale* dhe pritjet për kontrata porositëse në tremujorin e ardhshëm.


*Çmimet* e prodhimit në sektorin e industrisë vijojnë prirjen rënëse të nisur që nga T2-08.

*Pritjet* e bizneseve për T1-09, në linjë me vlerësimet e bizneseve për situatën korente, janë në rënie; pritjet për situatën ekonomike dhe kërkesën për eksporte janë negative dhe në rënie. Kërkesa e brendshme e pritur, prodhimi dhe aktiviteti i pritshëm i biznesit, megjithëse në nivele pozitive, janë në rënie nga vrojtimi i kaluar.

### Sektori i ndërtimit

Treguesi i Besimit të Ndërtimit (TBN) u rrit me 4 pikë përqindjeje në T4-08 dhe aktualisht, qëndron sipër mesatares së tij afatgjatë. Vlerësimet pozitive dhe në rritje të bizneseve ndërtuese për *kërkesën* dhe për *prodhimin* në T4-08, përcaktuan rritjen e treguesit të besimit. Për sa i përket vlerësimeve të bizneseve për situatën e *punësimit*, balanca përkatëse vijon të jetë negative që nga tremujori i kaluar.

Grafik 3: Treguesi i Besimit të Ndërtimit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

#### Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBN.

Megjithëse *ecuria e ekonomisë* në vend për T4-08 vlerësohet negative dhe në rënie që nga vrojtimi i kaluar, bizneset e ndërtimit e kanë gjykuar të përmirësuar *gjendjen e përgjithshme të biznesit* të tyre. Problemet që kanë hasur më shumë bizneset e ndërtimit në aktivitetin e tyre janë prania e ekonomisë informale dhe pengesa të kuadrit ligjor dhe institucional.

*Inventarët* vlerësohen në rritje në T4-08. *Shfrytëzimi i kapaciteteve* të bizneseve ndërtuese, për të tretin vrojtim rradhazi është raportuar në nivelin 70%. Duke pasur parasysh kërkesën aktuale dhe pritjet për porositë në të ardhmen, 76% e bizneseve, e vlerësojnë të mjaftueshëm kapacitetin aktual të prodhimit të tyre.

*Çmimet* e prodhimit, megjithëse pozitive, kanë pësuar një rënie të ndjeshme nga vrojtimi i kaluar.


*Pritjet* e bizneseve të sektorit të ndërtimit për *kërkesën*, *gjendjen e përgjithshme të biznesit* dhe *prodhimin* në tremujorin e parë të vitit 2009 janë optimiste, megjithëse *klima*

e përgjithshme ekonomike pritet negative. Në T1-09 pritet pakësim i inventarëve dhe përmirësim në situatën e punësimit. Niveli i përgjithshëm i çmimeve pritet të rritet pak, por gjithsesi mbetet në nivele të ulëta në krahasim me mesataren afatgjatë.

### Sektori i shërbimeve

Treguesi i besimit të shërbimeve (TBSH) shënoi një rënie prej 7 pikësh përqindjeje në T4-08. Megjithatë, ky tregues qëndron dukshëm mbi mesataren e tij afatgjatë. Rënia në treguesin e besimit u shkaktua nga një vlerësim më pak optimist për të tre treguesit përbërës; ecuria e përgjithshme ekonomike, situata e punësimit dhe situata financiare.

Grafik 4: Treguesi i besimit të shërbimeve.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

#### Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBSH.

*Kërkesa* është vlerësuar në rënie në T4-08. Gjithashtu vlerësimet për gjendjen e përgjithshme të biznesit, megjithëse pozitive, vlerësohen në rënie nga vrojtimi i kaluar. Problemet lidhur me energjinë elektrike dhe me infrastrukturën janë gjykuar nga bizneset si faktorët kryesorë, të cilët kanë penguar zhvillimin normal të aktivitetit të tyre.


*Norma e shfrytëzimit* të kapaciteteve në T4-08 ka rënë në 73.6% nga 80% që ishte në tremujorin e mëparshëm. Pjesa më e madhe e bizneseve (64%) e vlerësojnë të mjaftueshëm kapacitetin aktual ndërsa 19% e tyre e vlerësojnë të tepërt, duke marrë parasysh kërkesën aktuale dhe pritjet për vitin në vijim.

*Pritjet* e firmave të sektorit të shërbimit janë disi më pesimiste krahasuar me vlerësimin e tyre për tremujorin referues. Pritjet për ecurinë e ekonomisë dhe gjendjen e përgjithshme të biznesit së tyre në T1-09 janë negative. Pritjet për kërkesën në tremujorin e ardhshëm janë pozitive, por në rënie nga vrojtimet e mëparshme.

## Besimi i Konsumatorit

Pas dy tremujorësh rritjeje të njëpasnjëshme, në T4-08 Treguesi i Besimit të Konsumatorit (TBK) pësoi rënie. Vlera e treguesit aktualisht qëndron më poshtë mesatares së tij afatgjatë. Rënia në treguesin e besimit u përcaktua nga pritjet pesimiste të konsumatorëve për situatën e tyre *financiare* dhe *ekonomike* për T1-09, si dhe vlerësimin negativ të situatës së *blerjeve* në shuma të mëdha dhe situatës së *kursimit* gjatë T4-08.

Grafik 5: Treguesi i besimit të konsumatorit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

### Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBK.

Situata financiare dhe ekonomike në T4-08 është vlerësuar negativisht dhe në rënie nga konsumatorët. Kostoja e jetesës vlerësohet më e përmirësuar, megjithëse balanca përkatëse shënon vlera negative edhe për këtë vërtetim.

Konsumatorët presin rënie në nivelin e përgjithshëm të çmimeve pas një tremujori dhe pas një viti. Konsumatorët presin që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 niveli i *papunësisë* të rritet. 49% e konsumatorëve janë shprehur se papunësia do të rritet gjatë vitit në vijim.

Tabelë 1: Treguesit e Besimit sipas sektorëve\*.

	vlerat që nga T2-2002			2007	2008					Situata	
	min.	mes.	max.	T4	T1	T2	T3	T4	Konjunkturale**	Strukture***	
Industri	-9.7	-0.2	9.1	9.1	0.9	1.2	0.0	-0.3	↓	-	
Ndërtim	-14.0	-1.1	10.1	10.1	8.2	7.4	-0.9	3.1	↑	+	
Shërbime	-16.5	1.7	19.6	2.0	5.1	7.0	19.6	12.7	↓	++	
Konsumator	-20.5	-12.9	-7.8	-11.0	-13.6	-11.7	-10.5	-17.4	↓	--	

\*) Me përjashtim të treguesit të besimit të konsumatorit, treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara sezonalisht.

\*\*) Situata krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

\*\*\*) Situata për secilin tregues konsiderohet shumë e kënaqshme (+ +) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e kënaqshme (+) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e pakënaqshme (-) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe situata konsiderohet shumë e pakënaqshme (--) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2: Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë\*.

	2007		2008				
	T3	T4	T1	T2	T3	T4	prirje T1-09
<b>Kërkesa</b>							
Total	4.1	8.1	4.2	4.2	8.5	6.3	5.2
Industri	0.9	12.0	1.5	-0.5	-0.9	-3.4	5.7
Ndërtim	-5.2	12.1	4.3	11.4	1.9	7.4	6.2
Shërbime	9.4	5.0	4.9	2.2	14.4	8.7	4.6
<b>Situata ekonomike e firmës</b>							
Total	-1.9	14.0	7.0	6.9	8.9	8.2	2.8
Industri	-9.4	18.0	-3.4	-0.4	-5.9	-2.4	1.0
Ndërtim	-9.4	7.7	5.7	7.0	-11.4	-0.3	12.0
Shërbime	3.9	9.5	10.7	9.1	22.9	15.4	-0.9
<b>Punësimi</b>							
Total	-3.4	9.7	3.8	2.2	11.1	6.7	5.7
Industri	-10.2	9.8	3.2	0.3	2.5	-5.1	4.3
Ndërtim	-13.3	9.4	4.2	4.1	-3.7	-2.2	0.7
Shërbime	3.3	9.5	3.8	1.9	20.6	14.4	8.4
<b>Prodhimi</b>							
Total	-10.3	10.8	11.0	3.5	-3.6	2.4	6.6
Industri	-11.6	14.0	3.2	-1.6	-7.2	-0.5	4.6
Ndërtim	-9.5	8.7	16.0	6.8	-1.2	4.2	7.9
<b>Konsumatorët</b>							
Situata financiare	-6.6	-9.6	-13.5	-9.7	-3.8	-9.9	-0.6
Kosto e jetesës	-9.0	-8.1	-4.6	-6.6	-21.1	-12.4	-12.1
Çmimet pas 1 viti	34.8	27.9	25.2	21.1	23.0	17.3	
Blerje të mëdha	-49.2	-45.7	-50.9	-45.8	-43.7	-52.7	-39.3
Kursim	-50.0	-52.8	-53.2	-50.3	-50.6	-54.4	-53.1

\*) Me përjashtim të treguesit të konsumatorit, balancat janë të rregulluara sezonalisht.